Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
710-717-724-727/20
12.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

# RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | |
|---|---|---|---|
| ***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit 02.10.2020* | *Data e dorëzimit të raportit 12.10.2020* | Nr. i lëndës: *710-717-724-727/20* |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.09.2020,OE "Selmans Network"Shpk-Prishtinë,datë 22.09.2020, OE"Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc,datë 26.09.2020,grupi i OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk"-Ferizaj dhe datë 27.09.2020, OE"Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë,kanë parashtruar ankesë me nr: 710-717-724-727/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit,"Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapsirave të jashtme dhe të mbrendshme të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina" me nr.të prokurimit: 242/19/5702/211,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Universiteti i Prishtinës".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Kornizë,**Shërbim**,vlera e parashikuar e kontratës: **2,520.000.00 €.**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka dy vendime të OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020 me të cilin është rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS GRUPIT TË OE NSH "CLEAN"; "REXHA SHPK"

*(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 60 i LPP-së**

Grupi i OE N.Sh'CLEAN"&"Rexha"Shpk pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit,pasi është njoftuar nfa AK për mes Njoftimit mbi Vendimin e AK me dt.17.09.2020 për mes të cilit është njoftuar se për këtë aktivitet të prokurimit ku komisioni i vlerësimit ka rekomanduar që ky aktivitet të anulohet pasi sipas tyre asnjë nga ofertuesit nuk i plotëson

kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit,andaj duke u bazuar në raportin e vlerësimit,zyra e prokurimit vendos që të anuloj këtë aktivitet të prokurimit.
Pas njoftimit për mes këtij Vendimi Përfaqsuesi i Kompanisë tonë ka qenë i obliguar ti drejtohet zyrës së prokurimit se kërkon qasje në dokumentet tenderik duke pretenduar se në bazë të këtij Njoftimi Vendimi AK ka bërë shkelje të Nenit 59 dhe 60 LPP.

Ne si OE të përgjegjshëm sipas kritereve të kërkuar në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit ku mendojme se AK ka bërë shkelje të ligjit pasi që ne jemi eleminuar nga kjo garë pa nodnjë arsye reale.
Sa i përket të gjeturave nga komisioni vlerësues dhe zyra e prokurimit ku keni cekur se nuk kemi sjellur Qertifikaten Smeta Sadexs i dhe nuk ofrojme listen e projekteve mbi 2,500,000.00 € ku keni cekur se te lista e kontrata nuk janë sipas natyrës së kontratës pastrim dhe mirëmbajtje të objekteve.

Sqarim për zyren e prokurimit dhe komisionin vlerësues:

Ne si grupi i OE N.Sh'CLEAN"&"Rexha"Shpk me përgjegjësi të plotë morale dhe materiale lidhur me dy pikat të cilat komsioni vlerësues pretendon se nuk janë plotësuar,deklarojme se sa i përket qertifikatës Smeta Sadex kemi marr sqarim me shkrim nga kompania e autorizuar tek e cila jemi çertifikuar.Sipas sqarimit ne fjalë,standradin SA 8000 për të cilin kemi ofruar dëshmi certifikimi,është i vetmi që mbulon fushën e përgjegjësisë sociale dhe që është i pranuar nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).
Standardi SA 8000 i krijuar më 1997 nga Përgjegjsia Social Ndërkombëtare (SAI), si standard i parë në këtë fushë siguron një kornzië të përgjithshme që dëshmon se organizatat që mbajnë këtë qertifikatë trajtojnë punonjësit më korrektsi dhe ky është njëherit standard kryesor çertifikimi shoqror për të gjitha fabrikat dhe bizneset në të gjithe boten. Ky standard thekson pjesëmarrjen e punonjëseve,e përqendrohet në matjen e përformancës sociale ne tetë fusha të plotësuara nga një sistem menaxhimi që siguron përmirësim të vazhdueshëm dhe është i rëndësishëm për përgjegjshmërine sociale në ndermarrje.Standardi SA 8000 adapton një qasje rigoroze për të siguruar cilësinë më të lartë të pajtueshmërisë sociale në zingjirët e furnizimit dhe nuk kompremeton intereat tregtare.
Standardi i përgjegjësisë shoqrore SA 8000 pasqyron parimet e Konventave Universale të të Drjetave të Njeriut dhe Organizatës Ndërkombetare të Punës (ILO).Ai gjithashtu plotëson dhe mbështet rregullat ligjore vendore në gjithë botën dhe ndihmon për të siguruar kushtet etike të punës për miliona punëtor që punojnë aktualisht në sektor të ndryshëm.Në veçanti ai përputhet me sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001,sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001 dhe strukturen standarde te shendetit dhe sigurise profesionale të OHSAS18001.

Sadex përcakton Shkëmbimin e të Dhenave Etike të Furnizuesit,është një organizatë jo fitimprurëse dhe prezanton për të udhëhequr praktikat etike të biznesit.Sadex ndihmon në mirëmbajtjen e informacionit etik në një mënyrë të thjeshtë dhe efektive.Është një bazë e të dhënash e sigurt në internet e cila lejon anëtaret e regjistruar të ndajnë,ruajnë informacion në katër fusha kryesore:Standardin e Shëndetit dhe Sigurisë,Standardin e Punës dhe etika e biznesit.Blerësit mund të menaxhojnë dhe shikojnë të dhënat etike dhe informacionin për furnizuesit e shumëfishtë në nje vend dhe Furnizuesit mund të ndajne informacionin e tyre etik ose të dhënat për blerës të shumtë në një vend të sigurt.

**Çertifikimi me SADEX nuk bëhët nga asnjë kompani në Kosovë dhe është krjtësisht pa ndikim në fushën e menaxhimit të kualitetit në zbatim të shërbimeve.**

Sa i përket pikës tjetër rreth referencave për qarkullimin e jo më pak 2,500,000.00 €(euro) ne ju garantojmë se si grup i operatorëve ekonomik e plotësojmë edhe këtë kriter dhe jo vetëm në shumën e lartëcekur,por figurojnë dëshmi se e tejkalojmë këtë shumë duke llogaritur tek kontratat e realizuara dhe referencat për shërbimet e kryera në mirëmbajtjen e parqeve,të kanalizimeve, të nyjeve sanitare,të ngjitjes të rrjetit elektrik,të cilat mendojmë se janë aktivitete të natyres së ngjashme dhe përcjellëse.Edhe në dosjen e tenderit (në UP) janë paraparë shërbime që janë pjesë e kontratës e që

duhet të realizohen në sipërfaqe të konsiderueshme të jashtme,e të cilat ndërlidhen drejtëpërdrejtë me mirëmbajtjen dhe nuk konsiderohet aktivitet i ndarë nga pastrimi.Po ashtu shërbime të cilat u përmenden me lartë.

Kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit që t udhëzoj AK të shpallemi fitues duke marre parasysh faktin se jemi të përgjegjshem dhe ka diferencë të theksuar në çmimin e ofruar nga ne në raport me OE të tjerë në radhe.

**DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "SELMANS NETWORK" SHPK**

*(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 28 i LPP-së**
**Neni 56 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 72 i LPP-së**
**Neni 62 i LPP-së**

AK – Universiteti i prishtinës ka bërë shkelje të LPP-së gjatë procedurës së vlerësimit të Ofertave me çka ka vepruar në kundërshtim me Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

Autoriteti kontraktues UNIVERSITETI I PRISHTINËS"HASAN PRISHTINA" perkatësisht Komisioni Vlerësues ka vepruar në kundërshtim me Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesat e dosjës së tenderit dhe specifikimet teknike në dosjën e tenderit me rastin e Anulimit të procedurës së Prokurimit.

Duke parë raportin përmbledhës të vlerësimit verehët qartë që AK – Universiteti i Prishtinës ka bërë shkelje esenciale të ligjit të prokurimit publik, nenit 7 barazia në trajtim/jo diskriminimi për faktin se AK është hera e katërt që formon komision për vlerësimin e ofertave e ku në dy komisionet e fundit ka konstatuar se nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme me çka ka rekomaduar anulimin e aktivitetit të prokurimit e që këtu bi ndesh edhe me rekomandimet e Vendimit të OSHP-së, Me poshtë do të japim një kronologji:

a. Në Komisionin e parë vlerësues në të cilën është shpallur fitues OE CLEAN & Rexha si më i liri në këtë procedurë. Ky komison ka rekomaduar një OE që as për së afërmi nuk ka plotësuar kërkesat e dosjës së tenderit duke filluar prej gabimeve aritmetike në vlerën me të madhe se +/-2% e deri tek kërkesat tjera e ku me vendim të OSHP-së është vertetuar se ky OE është i Pa -përgjegjshëm dhe kjo lëndë është kthyer në Rivlerësim. Ky komision gjatë vlerësimit të ofertave ka shpallur të gjith OE të përgjegjshëm edhe OE ne fjalë që në këtë procedurë ka qenë OE më i pa përgjegjshëm dhe është munduar të gjejë "gjilpërën ne kashtë" për OE Selmans Netëork duke pretenduar se gjaja nuk përmbushim kërkesat për realizim të kontratave në tre vitet e fundit pavaresisht se vetem me AK kemi pasur më shumë se 2 milion kontratë dhe referencë.
b. Në Komisionin e dytë pas vendimit të OSHP-së, AK Universiteti i Prishtinës, pas shumë

verifikimeve të bëra për kompaninë tonë "me theks të veqantë vetem për kompaninë tonë" neve si OE na shpall të "përgjegjshëm por që nuk ishim me çmimin më të lirë" dhe shpall si fitues të kësaj procedure OE Kristal & Pasrime Silvio ku pas ankesave të bëra në shkallën e parë AK duke vlerësuar që ka vepruar gabim ngase OE i rekomanduar për kontratë nuk ishte OE i përgjegjshëm me qimin më të lirë dhe lëndën e kthen në rivlerësim.

c. Duke qenë se këta dy OE janë verësuar nga komisionet si OE të papërgjegjshëm si në aspektin teknik ashtu edhe në atë administrativ AK Universiteti i Prishtinës krijon komision të ri, i cili sipas procedurës fillon të bëjë vlerësimin e dokumentacionit (kuptohet tani duke filluar nga OE më i lirë në radhë që ishim ne si OE SELMANS NetWork). Së pari ka qenë shumë e quditshme për ne kur kemi filluar të marrim pyetje nga AK të cilat në këtë fazë është dashur të konsiderohen si qështje të zgjidhura, ngase ne si OE nga një komision i më hershëm vetem ishim vlerësuar si të përgjegjshëm. Por, duke respektuar të drejten e komisionit që të hulumtoj për secilin dokumet ne si OE kemi kthyer sqarimet e nevojshme të argumentuara me dokumente zyrtare nga Institucionet shtetërore duke konsideruar që ato janë të mjaftueshme dhe kanë besueshmërinë e nevojshme. Ateher çfar bënë AK Universiteti i Prishtinës, fillon të bëjë verifikimin e secilit dokument duke ju shkruar institucioneve të cilat kanë lëshuar këto dokumente duke luajtur rolin e "prokurorit" dhe duke u munduar që të gjejë ndonjë "presje" apo "Qime në vezë" me të vetmen arsye tendencioze që neve si OE të na Eleminoj dhe të kalohet tek ndonjë OE tjetër apo edhe siq ka vepruar ta anuloj procedurën. Ne si OE nuk kemi asgje kundër që të verifikohen dokumentet tona por është shumë e quditshmë dhe që tejkalon kompetencat e secilit komision vlerësues apo secilit organ që bën vlerësimin që të lëshohet në:

1. Nesë bënë verifikiomin e dokumentit nga institucioni zyrtar dhe merr përgjigjet nga ai institucion nuk guxon që pastaj të dyshoj në vertetësinë e atij dokumenti apo të mos i falë besimin. Dhe
2. Nuk guxon që të bëjë përzgjedhje selektive që vetem një OE ti bëhët ky verifikim dhe të shiqoj dokumentet me "llupë" e kurse për OE tjerë edhe për faktet ma vendimtare si "Gabimet Aritmetike" në masën më të madhë se +/-2% të mos nxjerrë asnjëher vendim pavarësisht pretendimeve ankimore të OE tjerë. (rasti me OE Cleain & Rexa)

Si fakte kësaj kërkese për rishqyrtim do ti bashkangjisim edhe dokumentet të cilat vertetojnë se ne si OE plotësojmë kërkesat e dosjës së tenderit dhe se AK Universiteti i Prishtinës që nga fillimi i vlerësimit të kësaj procedure është duke vepruar në menyrë selektive dhe diskriminuese në raport me OE pjesmarrës.
Lidhur me pretendimet tona sqarimet jipen edhe sqarimet e KRPP-së tek pyetjet e shpeshta, e të cilat AK duhet ti marrin për bazë gjatë Vlerësimit

Citojmë: ...në kuptim të nënparagrafit 4.2 të nenit 69 të lartë cituar, AK nëse kërkon Deshminë -Listen e Kontratave të realizuara në tre vitet e fundit .... Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit e jo e fillimit të kontratës..

Prova 1: Referenca e Spitalit të Gjakovës (vlera 899,868.24)
Prova 2: Referenca dhe konfirmimi e Komunës së Pejës (Vlera 794,880.00)
Prova 3: Referenca e Universitetit të Prishtinës (vlera 1,733,206.78)

Që AK Universiteti i Prishtinës në raportin e vlerësimit të tenderëve nuk ka vlerësuar drejt dhe ka bërë

shkelje të ligjit dhe të dispozitave të LPP-së, RRUOPP dhe ka bërë tejkalim të kompetencave të tij, do të argumentojmë më poshtë:

1.Në raportin e vlerësimit të Komisionit Vlerësues në pikat që kanë të bëjnë për SELMANS Netëork thuhet: "OE SELMANS NETWORK, ka dorëzuar listën e projekteve të realizuar, por nuk ka ofruar edhe dëshmitë si referencën apo raportin të lëshuara nga AK për kryerjen e shërbimeve. Kontrata me Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës - loti 1 është nënshkruar nga OE SELMANS NETWORK me date 6.10.2016 dhe sipas neneve të kontratës me një kohëzgjatje 36 muaj dhe po ashtu është e nënshkruar nga kryesuesi i BD të SHSKUK (këtë rast që është edhe AK e cila ka iniciuar procedurën e shpalljes se tenderit) është e nënshkruar me date 4.10.2016. Komisioni konstatoi se kjo kontrate nuk mund të merret si e përfunduar para datës 6.10.2019. Kjo sqarohet edhe në shkresën e dorëzuar nga Sadri Kastrati - Menaxher i prokurimit të SHSKUK, e datës 11.07.2016. Shkrese të cilën e ka bashkangjitur në këtë kontrate OE Selmans Netëork. Pra, data 6.10.2016 paraqet edhe datën që kontrata është nënshkruar nga të gjitha palët. OE SELMANS NETËORK nuk ka ofruar dëshmi sikurse referencat apo raportet e AK për përfundimin e disa kontratave të dorëzuara."

SQAROJMË: Selmans Netëork me rastin e dorëzimit të tenderit ka dorëzuar listat e kontratave dhe referencave sipas kërkesave të DT-së, zyra e prokurimit duke respektuar LPP dhe kopetencat që burojnë nga LPP ka bërë kërkesë për sqarime shtesë lidhur me listën e Kontratave dhe referencave që përmbushin kërkesat e DT-së për qarkullim prej 2,500,000 euro, Sqarime këto të cilat ne i kemi dorëzuar në UP brenda afatit të kërkuar ligjorë sipas Kërkesës për Sqarimin e Tenderit. Prandaj pretendimi i Komisionit Vlerësues së e si OE nuk kemi përmbushur kërkesat e për kontrata dhe referenca në vlerë prej 2,500,000 nuk qendron ngase ne si OE jo vetem që kemi përmbushur këtë kriter por edhe e kemi tejkaluar shumë herë me vlerën e kontratave dhe referencave. Dhe në përgjen tonë ne kemi dorëzuar listën e kontratave dhe referencave që tejkalojnë vlerën e kërkuar sipas DT-së e që janë:

a. Uniersiteti i Prishtinës ---- me vlere te kontrates prej 1,733,206.78
b. Spitali i Gjakoves ----------me vlere te kontrates prej 899,868.24
c. Komuna e Pejës ----------me vlere te kontrates prej 794,880.00
d. Universiteti i Pejës---------- me vlere te kontrates prej 92,241.08
e. Universiteti i Gjakovës----- me vlere te kontrates prej 133,232.08
f. Universiteti i Gjilanit------- me vlere te kontrates prej 100,523.88

TOTALI: 3,808,952.06

Duke mos i mjaftuar sqarimet tona dhe dokumentet zyrtare nga Autoritetet Kontratuese ne fjalë, AK Universiteti i Prishtnës ka luajtur edhe rrolin e Prokurorit duke ju shkruar direkt autoriteteve kontraktuese për sqarime tjera plotësuese, sqarime këto të cilat i ka marrë dhe të cilat kanë vertetuar pretendimet tona, dhe prap se prap nuk është mjaftuar duke bërë kështu shkelje të ligjit të LPP-së. Vlenë të theksohet vetem referenca nga Spitali i Përgjithshëm Isa Grezda për të cilën komisioni i është referuar në arsyetimin e tij të cilën AK Universiteti i Prishtinës ka vertetuar se kur ka filluar dhe ka përfunduar jo vetem përmes nesh por edhe duke ju shkruar zyrtarisht institucionit të cilin e ka lëshuar e që është e quditshme si si nuk ja falë besimin. Në arsyetimmin e tij AK thirret në një datë të nënshkrimit të cilën ne si OE e kemi bërë e që sipas komisionit ajo është data e fillimit dhe e përfundimit të punëve e jo letra zyrtare dhe përgjigjet e marra nga institucioni shtetëror i cili e ka lëshuar atë. Në këtë rast komisioni

me rastin e përgjigjës zyrtare nga AK Spitali i Përgjithshëm Isa Grezda është dasur që ta marrë të mirëqenë letren zyrtare nga ta apo në të kundërtën është dashur që të ngrit kallxim penal për mashtrim apo për falsifikim të dokumentit si ndaj institucioninit që e ka lëshuar, ashtu edhe ndaj nesh si OE. "Fshehja e fakteve është vepër penale". Në të kundërtën Komisioni vlerësues me asnjë të drejt nuk guxon të dyshoj apo të vlerësoj nësë një intitucion tjetër shtetëror ka lëshuar me të drejt apo jo një dokument por duhet ta marrë atë si të mirëqenë dhe të vlerësoj vetëm se a përmbush apo jo kërkesat e dosjës së tenderit.
Gjithashtu, sa për sqarimin e Ekspertit Vlerësues të OSHP-së dhe Panelit Shqyrtues të OSHP-së, ju bëjmë me dije se sipas LPP-së dhe ligjeve në fuqi, tek Kontratat Publike Kornizë data e fillimit të kontratës nuk mund të lidhet me datën e përfundimit të saj, por me vlerën dhe sasinë e shërbimeve të ofruara. (LPP, Neni
38, Kontrtat Publike Kornizë)
Duke u nisur nga e gjith kjo që u tha me lartë, hipotetikisht po nxjerrim një përfundim tjetër: e marrim me gjasmë që kjo kontratë dhe referencë e Spitalit rajonal të Gjakovës nuk plotëson egot apo pretendimet e Komisionit Vlerësues të pa bazuara në ndonjë kërkesë apo ligj por vetem në hamendësimet e tyre. Atëher, SELMANS Netëork prap se prap përmbushë kërkesat e DT, me vetem dy kontrata tjera:

a. Uniersiteti i Prishtinës ---- me vlere te kontrates prej 1,733,206.78
b. Komuna e Pejës ----------me vlere te kontrates prej 794,880.00

TOTALI: 2,528,086.78

Pra është e quditshme se si komisioni nuk ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin apo me qëllim nuk ka dashur që të vlerësoj këtë dokumentacion duke u munduar të nxjerrë " qime në vezë" vetem e vetem që të bëjë me vetëdije shkelje ligjore për të na eleminuar ne si OE. Për komisionin do të kishte qenë me lehtë sikur të thoshte nuk vlenë as referenca që ka lëshuar vet AK Universiteti i Prishtinës dhe të jepte një përgjigje që ky dokumet nuk plotëson kërkesat e AK ngase ky komision ka kërkesa të vetat të çuditshme.

2. Për ne si parashtrues të kësaj Ankese është i quditshëm edhe fakti se me rastin e qasjës në dokumente zyrtare, në dokumentacionin e ofertave kemi hasur në një raport tjetër të vlerësimit të këtij tenderi më përbërje të njejt, i cili ka qenë i ndarë në komentet e anëtarëve rreth plotësimit të kritereve nga ana jonë, dhe në një shkresë tjetër të zyrtarit të prokurimit, që sipas shkresës së drejtuar për ZKA e Universitetit të Prishtinës, shihet që drejtori i Prokurimit i cili është përgjegjës për Prokurimin Publik në UP, nuk është pajtuar me mendimin e Komisionit vlerësues dhe që sipas ligjit ka kërkuar që ky komision të nderrohet dhe të formohet komision i ri. Dokumentacion të cilin ne e kemi kërkuar që ta kemi por që nuk na është dhëna nga zyrtari i prokurimit me arsyetimin se nuk është relevant për këtë qështje dhe se gabimisht ka mbetur në këto dosje. Mirëpo, për këto pretendime tonat dhe menyrat e rrjedhës së kësaj procedure ne si kompani kemi ngritur dyshimet tona përmes emaileve zyrtare me Menaxhmentin e UP-së, dhe dyshojmë se ka pasur nderhyrje në punën e zyrës së prokurimit dhe se për këtë qëshje do të merremi me vonë pas përfundimit të kësaj procedure.

3. Zyrtari i prokurimit duke u bazuar në këtë shkresë të cilën e kemi parë por që nuk e kemi fizikisht është dashur që të veproj sipas LPP-së dhe RRUOPP, neni 40.13 ku thuhet: "Vendimi

përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Ne situata te tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund te nxjerr vendimin përfundimtar ose mund te formoj komision te ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjehere do te informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim"

4. SA I PËRKET OPERATORVE TJERË PJESMARRËS

A. OE CLEAN & Rexha, si më i liri në këtë procedurë as për së afërmi nuk plotëson kërkesat e dosjës së tënderit. Duke filluar prej gabimeve aritmetike në vlerën me të madhe se +/-2% e deri tek kërkesat si të certifikatat e ISO e deri te kontratat për shërbime të ngjashme, e ku me vendim të OSHP-së është vertetuar se ky OE është i Pa -përgjegjshëm. – AK ka vlerësuar drejt

B. OE Kristal & Pasrime Silvio sh.p.k si i dyti me radhë që nga një komision vlerësues i AK-Universiteti i Prishtinës ishte shpallur fitues i kësaj procedure pas ankesave të bëra dhe pas prezantimit të fakteve e që shkojnë deri në shkaktim të veprës penale të falsifikimit të dokumentit të kontratave dhe të vertifikatave të ISO-ve, është terhjekur nga kjo procedurë. - AK ka vlerësuar drejt.

C. MSS Mobile Sanitary Services SH.P.K nuk ka mundur të deshmoj se është i përgjegjshëm sa i përket kriterit për përshtatshmërinë profesionale "kopje të certifikatës së noterizuar të SA 8000 dhe Smeta Sadeks për përgjegjshmërinë socile dhe etikës në punë."- AK ka vlerësuar drejt

D. OE SCHAFBERGER JR.GMBH; " ERIK " SH.P.K.; "KRASNIQI"SH.P. K, Nuk ka mundur të deshmoj se është i përgjegjshëm sa i përket kriterit për përshtatshmërinë profesionale "kopje të certifikatës së noterizuar të SA 8000 dhe Smeta Sadeks për përgjegjshmërinë socile dhe etikës në punë.". Ky OE nuk ka dorëzuar farë certifikatën e Smeta Sadeks por pasi që lënda është kthyer në rivlerësim për herën e dytë ka dorëzuar një raport të Smeta Sadex që mbanë datën pas hapjës së dosjës së tenderit e që është në kundershtim me LPP-në. - AK ka vlerësuar drejt

E. EFA DIENSTLEISTUNG GMBH - DEGA NË KOSOVË; EFA DIENSTLEISTUNG GMBH – nuk plotëson kërkesat e dosjës së tenderit përpos argumentit të listuar nga komisioni i vlerësmit për kontratat dhe referencat, dokumentacioni i kësaj dosjës së tenderit përmban shumë elemente për të cilat është terhjekur nga kjo procedurë OE Kristal & Pasrime Silvio sh.p.k.- AK ka vlerësuar drejt.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që me rastin shqyrtim të Ankeses tonë të marrë parasyshë pretendimet tona dhe lëndën ta kthej në RIVLERËSIM dhe në të njëjtën kohë të rekomandoj AK që ne si OE të shpallëmi si fitues të kësaj procedure dhe të na ftoj për nënshkrim të kontratës, pasi që plotësojmë kriterin kryesorë për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, dhe ngase jemi i vetmi OE i cili ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas dosjës së tenderit.

**DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "SCHAFBERGER" GMBH**

*(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

**Neni 1 i LPP-së**
**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 54 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 62 i LPP-së**
**Neni 69 i LPP-së**
**Neni 70 i LPP-së**

*Pas publikimi të vendimit për refuzimin e kërkeses për Rishqyrtim me dt.17.09.2020 ne si pale e pa kënaqur ndaj vendimit të AK në afatin ligjor të paraparë me LPP-në paraqesim pretendimet tona si OE përgjegjjese në këtë aktivitet përmes kësaj ankese në OSHP.*
*Ne përmes kësaj ankese i bëjmë me dije panelit shqyrtues se AK –Universiteti i Prishtinës nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së të datës 15.07.2020 me nr.368/20,374/20 dhe 384/20 vendim ky i fundit i nxjerrur për këtë aktivitet.*
*Duke mos e përfilluar asnjë pretendim tonin në ankesat e bëra,pretendime këto të bazuara me mendim të eksperiti dhe me vendime të OSHP-së, AK ka dhëne vendimin e anulimit të këtij aktiviteti .*
*Arsye e anulimit të aktivitetit sipas vendimit të shpallur më datë 08.09.2020 është se të gjithë OE-ik janë të papërgjegjshëm dhe kjo ky vendim është ardhur si rezultt i Raportit të rivlerismi.*
*Duke u mbeshtetur në mendimin e ekspertit dhe vendiminin e OSHP-së nr. nr.800-805,812-821/2019 me dt.17.12.2019 në bazë të ligjit të prokurimit publik neni 72 pas kërkesës për sqarim është dorzuar ky raport dhe ne si Konzorcium kemi plotesuar kushtet dhe kërkesat e DT dhe njoftimit për kontratë.*
*Prezantimi i Raporti Smeta SADEX me datë 17.01.2020 të Autoriteti Kontraktues është dashur të merrët për bazë dhe të konsiderohemi kompani përgjegjese sepse*
*asnje kompani tjetër e cila është marrë si e përgjegjeshme në këtë standart nuk ka prezantuar raportin e Çertifikimit Smeta Sadex..*
*Mirëpo në raportin e rivlerismit të datës 08.09.2020 Komisioni i vlersimit i AK-se ka konstatuar se vetëm në këtë pikë ne si grup ekonomik jemi të papërgjegjshëm dhe më këtë konstatim ne nuk pajtohemi.*
*Duke qenë se dosja e tenderit nuk e ka spieguar qartë kërkesën sepse SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI len të kuptohët që ka te bej vetëm me nje standarte atëhere .SMETA SADEX është standart i ri në dhe sqarimet e AK kanë ardhur më vonesë se SA8000 dhe Smeta Sadex janë të ndara me njëra tjerën.*
*Për tu paisur me RAPORTIN Smeta Sadex është një procedurë e gjatë auditimi në të cilën duhët të kalojë kompania prandaj asnjë kompani nuk ka mundur të paiset më këtë raport.*
*Edhe OE MSS e cila ka prezantuar vetëm një rekomandi më të cilën deshmon se nuk mund të bëhet çertifikimi për një kohë të shkurtë për tu arritur para hapjes se tenderit.*
*Për të dëshmuar se je i çertifikuar në këtë standart për njohurin tuaj duhet të këtë raport audimi dhe nuk mund të deshmohet me çertifikat sikur që deshmohën ISO standertet prandaj për neve që kemi kaluar këtë auditimi me sukses dhe jemi paisur meRaportin Smeta Sadex çertifikatat e prezantuara nga OE-ik të tjerë janë të papranueshme.*
*AK –Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar një proces diskriminues në këtë aktivitet sepse me vendimin e AK të dt.29.10.2019 ka pretenduar të jap kontratë një konzorciumi i cili përpos mangesive tjera të shumta i ka*

*munguar edhe Raporti i Smeta Sadex për të cilin raport jemi duke u elminuar ne.Komisioni vlersues ka propozuar për kontratë OE me çertifikaten e njejtë të cilën e posedojme edhe ne SA8000.*
*AK ka bërë shkelje të LPP-së neni 7 barazia në trajtim/jo diskrimin.*
*Në këtë sqarim tonin është pajtuar edhe eksperit i OSHP-së dhe është i bazuar edhe me vendim të OSHP-së të dt.15.07.2020 nr. 368,374 dhe 384/20 duke konfirmuar kështu se kemi të drejtë në pretendimet tona.*
*Sipas raporteve te vlersimit dhe te rivlersimit te Autoriteti Kontraktues shihet se vetëm në kërkesën 1 të kërkesat mbi mundesit teknike dhe profesionale OE duhët të ofrojë deshmi të kënaqshme AK-së se ka kryer me suksesë shërbime në lemin e pastrimi të brendshme në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500.000.00 € po thuaj të gjitha kompanitë i keni të papërgjgjshme prandaj barazimi me këto kompani na bën të ndihmi të fyer moralisht sepse ne jemi kompani e vetme përgjegjese e cila ne të gjitha këkesat e AK jemi në pajtim.*
*Autoriteti kontraktues është në mospajtim më nenin 62 të LPP-së dhe draft rregullat dhe udhëzuesi për prokurim publik pika 44 .8 për anulimin e procedurës pas marrjes se ofërtave.*
*Ne perserisim prap pretendimet tona pasi te njejtat janë konsideruar të bazuara edhe më vendimin e OSHP-se të datës 17.12.2019 nr.800-805,812-821/2019 dhe i dt.15.07.2020 nr. 368/20,374/20 dhe 384/20.*
*Pretendimet tona bazohën në dokumetacionin e prezantuar nga OE, Raportin e Rivlersimit të AK-së ,Vendimet e OSHP-se nr. 800-805,812-821/2019& nr. 368/20,374/20 dhe 384/20 OE të cilat janë në pajtim me ekspertin shqyrtues prandaj i paraqesim deshmit per secilen OE pjesemarres si vijon:*
***1.OE Clean në konzorcium me "Rexha shpk"***
*Në dosjen e tenderit si kriter është kërkuar që të ofrohët deshmi të kënaqshme me vlerë prej 2,500.000.00 € në "lemin e pastrimit".ky konzorcium ka paraqitur tabela me lista te kontrateve për secilin antar të konzorciumi por shihet se lideri i grupit Clean nuk përmbushe këtë kriter ndërsa antari tjeter Rexha Shpk ka kontrata punë të realizuar në ndërtimit e shkollave dhe objekteve tjera te cilat nuk bëjnë pjesë në lemin e pastrimit.*
*Ky pretendim është konfirmuar si i bazuar me vendim nr.800-805,812-821/2019 të OSHP-së*
*Pastaj AK ka zbatuar nenin 72 të LPP-së,Dokumentacion dhe informatat shtesë ku ka kërkuar deshmin që OE e ka të punsuar një person përgjegje sipas kërkesave të ligjit ku kërkohet të deshmohet me kontratë dhe me trust dhe të njejtin nuk e ka paraqitur me dokumentat ofertues në sistemin e Eprokurimit.*
*OE e shpallur si fitues të këtij aktiviteti ka derguar përmes emailit një çertifikate të Selatin Krasniqit në fushën e Sigurise dhe Shendetit në Pune se bashku me kontratë të punës e cila është e lidhur me datë :01.03.2019 mirëpo nuk e ka deshmuar me trust pensional ashtu siq është kërkuar në dosjën e tenderit qe ky person është në mardhënie të punës në këte kompani nga data e nënshkrimit të kontratës se punës.*
*Kjo është një shkelje tjetër e ligjit të Prokurimit Publik përkatesisht nenit 59.*
*Po ashtu është paraqitur në këtë email edhe një çertifikatë e Z.Egzon Bytyqi që ka ndjekur një trajnim lidhur me mënyren e perdorimit të aparteve për shurjën e zjarrit e i punsuari figuron si i punësuar në ndërmmrjen "Coyote Clean Group" me seli ne Kline që është e pakuptueshme sepse ky person nuk ka kontratë me asnjerën kompani në konzorcium dhe nuk e dim se qka ka dashur të deshmoj konzorciumi me këtë?*
*Konzorciumi ka pasur gabime edhe ne llogaritje te analizes fianciare dhe te pershkrimi i çmimeve.Të gjitha këto pretendime janë trajtuar me vendimin e e dt.17.12.2019 nr.800-805,812-821/2019 dhe nga ky vendim është konstatuar si OE e papërgjegjshmer edhe e elimuar nga ky aktivitet.(Grup Ekonomik i propozuar nga AK per kontrate me vendim te dt.29.10.2019).*
*Në vendimin nr. 368/20,374/20 dhe 384/20 nuk është trajtuar pasi nuk ka qenë pal interesi sepse është pajtuar me vendimin e anulimit të AK të dt.27.05.2020*
*Raporti i vlersimit te AK i datës 07.08.2020 ka nxjerrur kete Grup ekonomik te papergjegjshem në Kërkesën 7 ,Mungesa e Smeta Sadex,Kërkesën nr.1,Deshmit ne referenca dhe kontrata.*

*2.* **"NTSH Kristal &Pastrime Silvio SHPK"** *, nuk është pale e interesit pasi ështe terhequr nga ky aktivitet.*

***3."Selmans Netëork"***

*Sa i perket OE "Selmas Netëork" në kriterin e vendosur në Dosjën e tenderit që të ofrohet deshmi të kënaqshme me vlerë prej 2,500.000.00 € në "lemin e pastrimit" nga eksperti i OSHP-së dhe vendimi nr. 800-805,812-821/2019 eshte konstatuar se nuk ka rritur te plotesoj kete kriter dhe kjo është konfirmuar edhe njehërë me raportin e rivlersimit të AK e edhe me vendimin nr. 368/20,374/20 dhe 384/20 të OSHP-së Citoj vendimin e OSHP-së të dt.17.12.2019 "Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE "Selmans Netëork"shpk ka dorezuar nje liste te kontratave te realizuara dhe nje liste te kontratave ne realizim .Ne kuader te listes se kontratave te realizuara ka prezantuar dy referenca mbi realizimi e kontratave por qe nuk permbushin shumën e kërkuar prej 2,500.000.00 € sipas kërkesës së DT.Referenca e parë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës në vlerë prej 1,733,206.78 € për kontratën e përfunduar me dt.31.03.2017 është konform dosjes se tenderit.Referenca e dytë e lëshuar mga KK Gjakovë për kontratën me numer identifikues 632-16-013-211 e lidhur me datë 01.06.2018 me afat deri me 31.05.2020 me vlerë 118,862.88 € nuk dëshmon plotësisht realizimin e kontratës sepse kjo kontratë akoma është në implementim deri me datë 31.05.2020.Lista e kontratave tjera të prezantuara si kontrata në realizim nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar kontrata të realizuara (përfunduara)në tri vitet e fundit ,prandaj nuk plotësoht ky kriter..*

*Sipas ekspertit shqyrtues edhe sqarimet dhe dëshmitë e dorzuara në fazën e rivlersimit nuk e përmbushin kërkesën e dosjes se tenderit.Për kontratën e lidhur me Komunën e Pejës me datë 18.02.2015 për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të SHKÇK-së"sipas çmimit të shërbimeve mujore prej mujor 33,120.00 € ,OE ankues nuk ka oferuar referencë për realizimin e shërbimeve .Deshmia e dorëzuar nga OE ankues lidhur me këtë kontratë e cila mban datën 27.03.2020 që është e-mail nga Komuna e Pejës me të cilën vetëm konfirmohet se ka pasur një kontratë të nënshkruar në mes të Komunës së Pejës dhe OE'Selmans Netëork "SHPK por mungon referenca e realizimit te sherbimeve dhe për ekspertin shqyrtues kjo dëshmi /e-mail nuk përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit.Dy referencat tjera të leshuar nga Universiteti i Gjakovës në vlerë prej 133,232.08 € dhe Universiteti i Pejes në vlerë prej 92,241.08 €,njëra pa datë të lëshimit dhe tjetra me datë 30.03.2020 nuk arrijnë të përmbushin vlerën e kërkuar prej 2,500.000.00 € për kontrata të realizuara në tri vitet e fundit.*

*Kërkesa e dosjes së tenderit ka qene shumë e qartë që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se OE ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500.00.00 € duke dëshmuar me një listë të kontratave ,kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave OE nuk ka mundur të ofrojë deshmi në asnjë faze të aktivitetit qe e permbush kete kriter.*

*Në ende mendojme se Raporti i vlersimi tè riskut është jo adekuat,provat e njè raportit tè vlersimi te paraqitur nuk janè ne pajtim me ligjin.*

*Te gjitha pretendimet tona jane te bazuar dhe te konfirmuar edhe me mendimin e ekspertit dhe dy vendimet e OSHP-se nr.800-805,812-821/19 dhe 368/20,374/20 dhe 384/20.*

*Kjo edhe njëhere është konfirmuar me Raportin e vlersimit te AK i datës 07.08.2020 ku është dalur si OE e papergjegjshem në Kërkesën nr.1,Deshmit ne referenca dhe kontrata.*

***4."MSS Mobile Sanitary Services"SHPK-***

*Pretendimi yn lidhur me oferten e Operatorit Ekonomik "MSS Mobile Sanitary Services"SHPK nuk përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet te këtë në pronësi ose marrje me qera kranin me lartësi min.15 m dhe një platformë me lëshim min.varje 25 m,për pastrimin e xhamave dhe fasadave të jashtme të objekteve dhe në këtë rast OE "MSS" nuk ka ofruar kontratë as dëshmi për pronësi.*

*Paneli shqyrtues në vendimin nr.800-805,812-821/19 ka konfirmu si të bazur ku konform mendimit te ekspertit profesional sqaron se në ofertën e dorëzuar nga OE "MSS Mobile Sanitary Services"SHPK rezulton një kontratë në "Inetrcorp" shpk për kryerjen e shërbimeve me kran,mirëpo nuk ka dëshmi se kjo paisje është konform platformës së kërkuar me lëshim me varje min-25 m për pastrimin e xhamave dhe fasadave të jashtme të objekteve .*
*Raporti i vlersimit te AK i datës 07.08.2020 ka nxjerrur këtë OE te papergjegjshem në Kërkesën 7 ,Mungesa e Smeta Sadex,Kërkesën e mjetëve për pastrimin e xhamave.*

***5.Konzorciumi "Efa Dienstleistung GMBH-Dega Kosove & Efa Dienstleistung GMBH "***
*Sa i perket Grupit te Operatoreve ekomik EFA –dega në Kosovë dhe EFA Dienstleistung GmBH në radhë të parë ky Grup Ekonomik është me çmimin me të lartë në këtë aktivitet por ne prap qëndrojmë prapa pretendimeve tona se qarkullimi financiar i paraqitur në ofertë është konforme kërkesave të dosjes se tenderit pasi që nuk është deshmuar se është bëre auditimi nga një kompani e licencuar në Gjermani e as dokumentet e paraqitura si qarkullim financiar nuk janë të leshuara nga organi shtetror Gjerman.*
*Krejt qka është paraqitur jane disa raporte të bëra nga ndonjë kontabilist apo ndonjë financier.Këtu është dilema jonë se ky grup nuk mund të i permbush kriteret në këtë aktivitet.*
*Ndërsa në Kosovë Grupi ekonomik nuk ka paraqitur fare qarkullim nga ATK.*
*Prandaj qëndrojme mbrapa pretendimeve tona që edhe ky OE në këtë aktivitet është i papergjegjjshem.*
*Raporti i vlersimit të AK-s i datës 07.08.2020 ka nxjerrur këtë Grup ekonomik të papergjegjshem në Kërkesën nr.1,Deshmit ne referenca dhe kontrata.*
*Nga kjo çka është thëne në këtë ankesë ekspertit shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues të OSHP-së i:*
***PROPOZOJME:***
***Duke marre parasysh se Autoriteti Kontraktues –Universiteti i Prishtines nuk ka respektuar vendimin i OSHP-së 368/20,374/20 dhe 384/20 dhe si Grupi Ekonomik i vetëm përgjegjjës në këtë aktivitet propozojme nga Paneli Shqyrtues që të nxjerr një Urdhëresë për këtë aktivitet duke urdhëruar që të shpallemi fitues.***

**DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "EFA DIENSTLESTUNG"GMBH**

*(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Vendimi i OSHP-së

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"ka inicuar aktivitetin e prokurimit me Titulli "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapsirave të jashtme dhe të brendshmë të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina" me numër të prokurimit 242-19-5702-2-1-1.

Aktiviteti në fjal ka filluar që në vitin 2019, deri tash më kemi dorzuar dy (2) kërkesa për ri-shqyrtim si dhe dy (2) ankesa së fundemi kemi dorzur një parashtresë të cilën e kemi dorzuar në OSHP me datën 02 shtator 2020. Dhe nuk kemi pranuar ndonjë përgjigjëjje.

- Prova: Kërkesat për ri-shqyrtim, ankesat, parashtresa

I nderuar panel në dy (2) nga ekspertizat dhe në dy (2) nga venimet të dala nga OSHP lidhur me ankesat tona i janë pranuar të gjitha pretendimet ankimore.

Në vendimin e OSHP-së të datës 15.07.2020 të githa pretendimet dhe arsyetimet e ofertës sonë janë pranuar dhe sqaruar. Si dhe rekomandimet e dhëna në ekpsertizë sqarojn kjartë dhe lënda kthehet në ri-vlerësim duke marrë përbazë aprovimin e ankesës tonë. Autoriteti Kontraktues, komisioni për ri-vlerësimin e ofertave nuk ka kërkuar nga ne ndonjë shkresë plotësuese apo sqaruese siq edhe rregullohet me dispozitat e LPP-së si dhe rekomandimet në vendimet tuaja.

- Provë: Vendimi i OSHP-së i datës 15.07.2020

Autoriteti kontraktues më datën 08.09.2020 ka marur vendim mbi anulimin e aktivitetit, dhe në ndaj këti vendimi kemi ushtruar kërkesë për ri-shqyrtim e cila është refuzur pa ndonjë arsyetim faktik.

- Provë: Kërkesa për ri-vlerësim e datës 10.09.2020 & Provë: Vendimi i AK-së.

Në raporte e pranura njëri më datën 07/08/2020 dhe 15/07.2020 në disa kolona shabllone të procedurës së raporteve pasi që është shënuar (në rregull ose Po) është fshir duke u shënuar (Jo ose thën ndryshe JPO). Lidhur me atë se ne nuk kemi plotësuar qarkullimin në vlerën e kërkuar aspak nuk qendron dhe deshmi me ofertën ishin referenca nga shteti Gjerman dhe raportet e auditimeve që nuk tolerojn as edhe një ndryshim. Për të cilat mund ti drejtoheni edhe institucioneve shtetërore në Gjermani, si dhe ambasades së Gjermanisë në Kosovë rast për të cilin e kemi njoftuar.

- Provë: Raportet e komisioneve ri-vlerësuese të datës 15.07.2020.

Në shtrojm këtë ankesë duke këkruar nga OSHP- që ta shtjelloj edhe një herë qendrimin e saj dhe të ven në zbatim vendimet e saj.

Ne do shkëpusim pjesë nga vendimet e juaja të cilat nuk janë zbatuar nga AK. Vendime të cilat janë tejët të kjarta për zbatim po të ekzistoj pak drejtësi.

Të drejtat sociale të punëtorëve që në fakt ne kemi ofertuar duke respektuar në përpikmëri pagat dhe të drejtat e tyre si çdo akt ligjore lidhur me ndjersën dhe dinjetin njerëzorë të tyre. Si dhe materjalin higjienik cilësore dhe të mjaftueshëm.

Në ekpertizën e datës 25.06.2020 numër 368/374/384/2020 një ndër rekomadimet e dhëna e në ekspertiz kërkohët ri-vlerësim edhe në çështjet finaciare të ofertave të ketë fokusim të veqant. Por edhe në vendim të Panelit Shqyrtues është kërkuar:

Gjatë procesit të rivlerësimit AK duhet të fokusohet më shumë në analizat financiare të OE se a janë konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe posaçërisht a i mbulojnë ofertat financiare kërkesat e ligjit të punës siç është kërkuar në dosje të tenderit.

| | Paga bruto 280 euro | |
|---|---|---|
| | | |
| Nr. | | |
| | Punëdhënësi | Primar |
| | Paga BRUTO | 280.00 |
| | PUSHIMI VJETOR | 23.33 |
| | KOSTO E PAGES | 303.33 |
| | Kontributi i punëdhënësit 5% | 14.00 |
| | PAGA BRUTO +5% KONTRIBUTI I PUNDHENSIT | 317.33 |
| | TOTAL KOSTO PER PUNËTOR | 317.33 |
| | TOTAL KOSTO PER 133 | 42,205.33 |
| | KOSTO PER PER 36 MUAJ | 1,519,392.00 |

| | Paga bruto 320 euro | |
|---|---|---|
| Nr. | Punëdhënësi | Primar |
| | | |
| | Paga BRUTO | 320.00 |
| | PUSHIMI VJETOR | 26.67 |
| | ORET E NATES | 96.00 |
| | ORET E FESTATVE | 3.64 |
| | VIKENDET | 10.51 |
| | KOSTO E PAGES | 453.18 |
| | Kontributi I punëdhënësit 5% | 22.66 |
| | PAGA BRUTO +5% KONTRIBUTI I PUNDHENSIT | 475.84 |
| | TOTAL KOSTO PER PUNËTOR | 475.84 |
| | TOTAL KOSTO PER 6 MIRËMBAJTES | 2,855.01 |
| | KOSTO PER PER 36 MUAJ | 102,780.47 |

| | Paga bruto 320 euro | |
|---|---|---|
| Nr. | | |
| | Punëdhënësi | Primar |
| | Paga BRUTO | 320.00 |
| | PUSHIMI VJETOR | 26.67 |
| | KOSTO E PAGES | 346.67 |

| | | |
|---|---|---|
| | Kontributi i punëdhënësit 5% | 17.33 |
| | PAGA BRUTO +5% KONTRIBUTI I PUNDHENSIT | 364.00 |
| | UNIFORMA | 0.01 |
| | TOTAL KOSTO PER PUNËTOR | 364.01 |
| | TOTAL KOSTO PER 16 MIRËMBAJTES | 5,824.16 |
| | KOSTO PER PER 36 MUAJ | 209,669.76 |

| | **Paga bruto 350 euro** | |
|---|---|---|
| Nr. | | |
| | Punëdhënësi | Primar |
| | Paga BRUTO | 350.00 |
| | PUSHIMI VJETOR | 29.17 |
| | KOSTO E PAGES | 379.17 |
| | Kontributi i punëdhënësit 5% | 18.96 |
| | PAGA BRUTO +5% KONTRIBUTI I PUNDHENSIT | 398.13 |
| | UNIFORMA | |
| | TOTAL KOSTO PER PUNËTOR | 398.13 |
| | TOTAL KOSTO PER 6 KRYEPUNËTOR | 2,388.75 |
| | KOSTO PER PER 36 MUAJ | 85,995.00 |

| | PËRMBLEDHJA | |
|---|---|---|
| 1 | PAGAT TOTAL | 1,917,837.23 |
| 2 | TVSH-JA | 345,211.09 |
| 3 | MATERIALI PER 36 MUAJ | 185,405.40 |
| 4 | UNIFORMA PËR 3 VITE | 2,500.00 |
| 5 | FITIMI KOMPANIS | 1,001.00 |
| | VLERA TOTALE PA METRA TE JASHTME | 2,451,954.72 |

| | |
|---|---|
| **METRAT E BRENDSHME** | 2,451,954.72 |
| **METRAT E JASHTME** | 54,000.00 |
| **VLERA TOTALE E OFERTES** | 2,505,954.72 |

- Provë: Kërkesa e AK-së në dosjen e tenderit

Ne deklarojm se në anlizen financiare kemi kalkuluar të gjitha kërkesat tuaja siq keni cekur:
Verejtje: OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet të përfshijë:

a. Pagat bruto per puntorë me te gjitha kontributet dhe tatimet duke perfshire edhe TVSH, sipas specifikacionit ne dosje te tenderit

b. Vleren e materialit shpenzues per pastrim sipas specifikacionit ne dosje te tenderit
c. Vleren per uniforma verore dhe dimerore sipas specifikacionit ne dosje te tenderit
d. Pagat e pergjegjesve dhe te menaxherit kryesor sipas specifikacionit ne dosje te tenderit,
e. Pagesat e kujdestarive për nderrimeve te nates për mirëmbajtësit sipas specifikacionit ne dosje te tenderit
f. Pagesat e kujdestarive për festat zyrtare
g. Zavendesimet e puntoreve me rastin e pushimeve vjetore
h. Vlerën e pajisjeve dhe instalimin e tyre në hapësirat e UP-së

Të gjitha ofertat e OE tjerë që janë nën vlerën e pagave të elaboruara në analizë janë të pa përgjegjëshme.

Arsyetimi i dhën në raportet e komisionit lidhur me qarkullimin e kompanisë e cila është prezantuar në ofertën tonë plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Në dosje te tenderit siq është shifet edhe në raportin e vlerësimit AK kishte kërkuar **"Dëshmi 1 OE duhet të ofroj listen e projekteve origjinale të realizuara në 3 vitet e fundit ku bashkangjitur duhet të ketë kontratat, referencat apo raportet të lëshuara nga AK për kryerjen e shërbimeve sipas natyrës se kontratës, jo me pak se 2,500,000.00€ Nëse kontrata është e lidhur me përsona fizik, dëshmi faturat dhe pagesat përmes bankës origjinale".**

Në vendimin e OSHP-së të datës 15/07.2020 lidhur me referencat e ofruara paneli shqyrtues ka cekur :

Lidhur me pretendimin OE "Efa Dienstleistung"Gmbh se AK gjate fazes se rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave, kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE "Efa Dienstleistung"Gmbh në ofertën e dorëzuar ka prezantuar një listë të kontratave dhe disa referenca për

realizimin e shërbimeve në lëmin e pastrimit. Referenca nga Zyra e Infrastrukturës/Landi i Shtugartit e cila është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe e cila për vitet 2016.2017 dhe 2018 është mbi 4 milion euro, plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Nga AK nuk është sqaruar në asnjërin nga vendimet e tyre arsyeja se përse këto referenca nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pra arsyetimi i autoriteti kontraktues se ne nuk jemi në rregull nga ana adminsitrative nuk qëndronë për faktin se në vlersimet e para nuk ka pasur ndonjë pretendim të tillë, por edhe pas "vlerësimit" të raporteve të fundit të komisioneve vlerësuese pas ankimimeve tona ka dalur se jemi në rregull me referencat e ofruara të konfirmuara nga eksperti shqyrtues por edhe Paneli gjithmonë duke u

respektuar LPP-në dhe kërkesat tuaja.

**Sipas LPP-së por edhe interpretimeve të KRPP ceket qartë se si duhet të veproj AK pas një vendimi OSHP-së:**

*34. Si të veprohet pas një vendimi të OSHP-së dhe/ose një opinioni të AKK-së?*

Përgjigjëja:

Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se: " Si duhet të veproj Autoritetit Kontraktues, në rastet e një vendimi te OSHP-se dhe/ose te një Opinioni te Agjencisë Kundër Korrupsionit e posaçërisht kur Opinioni i AKK-se e kundërshton një vendim paraprak te OSHP-se dhe /ose situata te ngjashme KRPP ne mbështetje te nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik, legjislacionit dytësor si dhe në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, KRPP iu ofron interpretimin ligjor si në vijim: Përkufizimet ligjore Në bazë të dispozitave të nenit 98 të LPP-së "OSHP-ja është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj". Për më tepër, neni 99 parashikon se " OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen (vetëm) nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative ". Sipas nenit 105, paragrafi 2. "OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX te LPP-se që: 2.1. të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji; 2.8. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të anuloj ose revokoj vendimin e autoritetit të tillë lidhur me - ose të marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme (...)". Sipas nenit 111, paragrafi 5 të këtij ligji, "Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1 të këtij neni OSHP menjëherë do të (i) caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë". Pavarësisht nga kjo çështjet e qe parashtruesi i ankesës i ka identifikuar ne njoftimin e paraqitur ne përputhje me paragrafin 5 dhe 6 te nenit 115 te këtij ligji do te shqyrtohen dhe vendosen nga OSHP (neni 116 i LPP-se). Bazuar ne nenet e përmendura më lart, mund të konkludohet me sa vijon: 1) OSHP-ja është subjekti përgjegjës për shqyrtimin e prokurimit, duke u titulluar nga vete LPP për pushtetin juridiksionin dhe kompetencat dhe autoritetin e nevojshme për ta bërë këtë. Sipas kësaj OSHP do te shqyrtoj Pretendimet ankimore te prezantuara nga pala ankimore ne ankesën e tij. 2) Vendimet e marra nga ana e OSHP-së lidhur me pretendimet ne ankesë janë plotësisht të detyrueshme dhe menjëherë ekzekutive për palët. Si pasojë secila prej këtyre palëve, duke përfshirë këtu autoritetet kontraktuese, duhet të respektojnë dhe zbatojnë vendimet e marra nga OSHP-ja lidhur me pretendimet e bëra ne ankese brenda afateve dhe kushteve të parashikuara nga LPP-së.

**Për mos respektimin e dispozitave ligjore nga ana e AK-së të thëna në vendimet e OSHP-së sipa Rregullores për parashtrim të ankesave thuhet:**

**Neni 12**
**Vendimi i OSHP**

12.1 Ne përputhje me nenin 105 te LPP-se, rastet e përsëritura me pretendimet te njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë te njëjta, për raste te cilat janë shqyrtuar me pare, kryetari i panelit shqyrtues duhet te trajtoj si çështje te gjykuar "res judicata".

12.2 Autoritetet kontraktuese, në përputhje me nenin 115.1 të LPP-së, brenda 15 ditëve nga data e ankesës (e

llogaritur si në vijim: 1 ditë për shqyrtim te ankesës; 10 ditë për vlerësim te ekspertit; 4 ditë për përgjigje te autoritetit kontraktues ne lidhje me vlerësimin e ekspertit), duhet ta informojnë parashtruesin e ankesës, ekspertin shqyrtues dhe panelin e shqyrtues, rreth vendimit të vet lidhur me çështjet e cekura në ankesë.

12.3 Nëse, në vendimin e tij, autoriteti kontraktues konstaton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme, dhe ankuesi nuk ka refuzuar, Autoriteti Kontraktues, brenda 5 ditëve ose kohës së lejuar nga eksperti, do të ndërmerr çfarëdo veprimi korrigjues të rekomanduar nga eksperti.

12.4 Nëse, brenda afatit kohor të specifikuar, autoriteti kontraktues nuk e nxjerr vendimin që e refuzon ose e mohon vlefshmërinë e një pretendimi ose që nuk e vlerëson farë vlefshmërinë e një pretendimi, ankesa do t'i referohet panelit shqyrtues.

Nisur nga ajo që u tha më lartë kërkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të aprovoj ankesën tonë dhe të udhëzoj Autoritetin Kontrakutues që të anuloj vendimin për anulimin e Aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në **ri-vlerësim.**

## KRITERET PËR VLERËSIM

*Kërkesa 7 OE të jetë i certifikuar me SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI – Përgjegjshmëria Sociale dhe Etika*

*Dëshmi 7 OE duhet të deshmoj kopje të certifikates (Noterizuar) SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI për Përgjegjshmërinë Sociale dhe Etikën në punë*

*Kapaciteti teknik dhe profesional:*

*Kërkesa 1.OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme AK-së se ka kryer me sukse shërbime në lëmin e pastrimit të brendeshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 €.*

*Dëshmia 1. OE duhet të ofroj listen e projekteve origjinale të realizuara në 3 vitet e fundit ku bashkangjitur duhet të ketë kontratat,referencat apo raportet të lëshuara nga AK për kryerjen e shërbimeve sipas natyrës se kontratës, jo me pak se 2,500,000.00€ Nëse kontrata është e lidhur me përsona fizik, dëshmi faturat dhe pagesat përmes bankës origjinale ).*

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

*Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni rivlerësues ka konstatuar si në vijim:*

*Komisioni për rivlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në raportin e tyre me datë 07.08.2020 rekomandojnë që aktiviteti i prokurimit të anulohet me arsyetimin se asnjëri nga tenderuesit nuk i plotëson kriteret e kërkuara duke i shpallur të gjithë OE pjesëmarrës të papërgjegjshëm.*

*Ofertën e OE "Selmans Netëork"Shpk,komisioni e ka shpallur të papërgjegjshme me arsyetimin se nuk ka përmbush kërkesën që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendeshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 €.*

*Ofertën e OE"Schafberger Jr"Gmbh e ka shpallur të papërgjegjshme me arsyetimin se nuk ka përmbush kërkesën që OE të jetë i certifikuar me SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI – Përgjegjshmëria Sociale dhe Etika*

*Oferten e OE"Efa Dienstleistung "GmbH,komisioni e ka shpallur të papërgjegjshme me arsyetimin se nuk ka përmbush kërkesën që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendeshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 €.*

*Ofertën e grupit të OE N.SH"CLEAN";"REXHA"Shpk,e ka shpallur të papërgjegjshme me arsyetimin se nuk ka përmbush kërkesën që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendeshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € si dhe kjo ofertë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat të përcaktuara në Dosjen e Tenderit është i papërgjegjshëm.*

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

*(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).*

///

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

*(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).*

///

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

*(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).*

///

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES NSH "CLEAN"; "REXHA SHPK"**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk",se AK gjatë rivlerësimit të tenderëve ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit,konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 €,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019, citoj një pjesë të vendimit të Panelit Shqyrtues "Lidhur me pretendimin e OE ankues "Schafberger Jr"Gmbh,se AK gjatë fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tendereve ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk edhe pse oferta e tyre nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe si e tille duhet të shpallej e papërgjegjshme.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se në Dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se AK ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave,kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave.Grupi i OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk ka ofruar kontrata të realizuara për secilin antare të grupit duke i prezentuar disa tabela për kontratat e realizuara.
Në tabelen e pare të ofruar për OE"Clean" janë prezentuar tri referenca:
Referenca e parë për kontratën e realizuar për Pastrimin dhe mirembajtjen higjienike te objekteve të Komunës së ferizajit në vlerë prej 209,398.00 € e përmbush kërkesën e DT.Kontrata ka filluar me date 16.03.2015 me afat 24 muaj.Gjithashtu edhe referenca per kontratën me Ministrine e Punëve të Mbrendshme për 'Shërbimet e pastrimit të objekteve të MPB-së" e lidhur me datë 25.07.206 me afat deri 31.07.2017 përmbush kërkesen e DT,por në këtë reference nuk ka çmim total dhe nuk dihet sa ka qene shuma e kontrates së realizuar.
Ndersa referenca e tretë e preznztuar në listen e kontratave dhe referencave për pastrimin dhe mirembajtjen e objektit të Qendrës së Sherbimit Emergjent Primar- Ferizaj në vlerë prej 38,400.00,në dokumentacionin e ofertes së dorzuar nuk ka reference të prezentuar.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se lista e ofruar nga OE "Rexha"(anëtar i grupit ekonomik) nga përshkrimi i projekteve rezulton se keto kontrata jane kontrata për punë.Të gjitha kontratat edhe referencat e bashkangjitura kane të bejne me ndërtimin e shkollave,ndërtimin e ambulancës,ndertimin e shtëpive dhe keto nuk mund të konsiderohen kontrata për shërbime në lëmin e pastrimit të brendshem.Andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

**Eksperti shqyrtues sqaron se oferta e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk edhe nga vendimi i AK dhe vendimi i Panelit Shqyrtues është shpallur e papërgjegjshme.**
**Tenderi i grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk në vendimin e AK-së të datës 27.05.2020 është shpallur tender i papërgjegjshëm dhe ky grup i OE nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim apo ankesë ne OSHP,andaj grupi i OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk konform nenit 4.1.26 të LPP-së duhet të trajtohet si palë pa interes material dhe juridik.**

**Pretendimi ankimor ëshë i pa bazuar.**

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "SCHARBERGER JR" GMBH**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Schafberger Jr "Gmbh, se AK gjatë rivlerësimit të tendëreve përsëri ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin e njejte se nuk përmbush kërkesën e 7. të dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të jetë i certifikuar me SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI – Përgjegjshmëria Sociale dhe Etika,që sipas OE ankues ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSH-së,PSH.nr. 368-374-384/20 të datës 15.07.2020,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në dy vendimet e OSHP-së PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj një pjesë të vendimit të fundit "Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE pjesërisht është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së,PSH.nr. 800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019. Konform vendimit të OSHP-së,AK ka kërkuar sqarime/dokumente shtesë për çertifikatat Smeta Sadex dhe BSCI të cilat janë dërguar nga ana e OE" Schafberger Jr "Gmbh" me datë 17.01.2020.
Edhe në ankesën e tyre OE sqaron se në momentin e hapjes së ofertave ka qenë në procedurë të auditimit nga një kompani e huaj për raportin Smeta Sadex dhe BSCI dhe për t'u çertifikuar për këtë standard duhet një auditim kompleks që zgjat për një periudhë disa mujore,andaj nga sqarimet e lartëcekura Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit profesional sqaron se pretendimi ankimor është pjesrësisht i bazuar për shkak se OE ankues ka qene në proces auditimi/çertifikimi për këtë standard,ndërsa në momentin e dorëzimit të tenderit nuk ka qenë i licencuar/çertifikuar me këtë standard të ri siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Sa i përket pretendimeve tjera të OE ankues "Schafberger Jr "Gmbh ndaj OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se këto pretendime janë trajtuar në dy vendimet e Panelit Shqyrtues,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020.

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "SELMANS NETWORK"SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin OE "Selmans Network"Shpk se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tendereve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit,konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave,kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave dhe sipas OE ankues përkundër asaj që ka dorëzuar listën e kontratave dhe referencave që tejkalojnë vlerën e kërkuar nga AK oferta e tyre është shpallur e papërgjegjshme,eksperti shyrtues ka këtë mendim.
Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj vendimin e OSHP-së lidhur me këtë pretendim "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE "Selmans Network"Shpk ka dorëzuar nje listë të kontratave të realizuara dhe nje listë të kontratave në realizim.Në kuadër te listës së kontratave të realizuara ka prezentuar dy referenca mbi realizimin e kontratave por që nuk përmbushin shumën e kërkuar prej 2,500,000.00 € sipas kërkesës së DT.
Referenca e parë e lëshuar nga UP'Hasan Prishtina" në vlerë prej 1,733,206.78 për kontraten e përfunduar me datë 31.03.2017 është konform dosjes së tenderit.
Referenca e dytë e lëshuar nga KK Gjakove për kontratën me numer identifikues 632-16-013-211 e lidhur me datë 01.06.2018 me afat deri me 31.05.2020 në vlerë prej 118,862.88 € nuk dëshmon plotësisht realizimin e kontratës sepse kjo kontratë akoma është në implementim deri me datë 31.05.2020.
Lista e kontratave tjera të prezentuara si kontrata në realizim nuk përmbushin kërkesen e dosjes së tenderit ku është kërkuar kontrata të realizuara(perfunduara) në tri vitet e fundit,andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.
Lista e kontratave të OE ankues të prezentuar në ankesën e tyre si dhe sqarimet dhe dëshmitë e dorëzuara në fazën e rivlerësimit nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.Për kontratën e lidhur me Komunën e Pejës me datë 18.02.2015 për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të SHKÇK-së" sipas çmimit të shërbimeve mujore prej mujor 33,120.00 €,OE ankues nuk ka ofruar referencë për realizimin e shërbimeve.Dëshmia e dorëzuar nga OE ankues lidhur me këtë kontratë e cila mban datën 27.03.2020 që është një e-mail nga komuna e Pejës me të cilën vetem konfirmohet se ka pasur një kontratë të nënshkruar në mës të Komunes së Pejës dhe OE"Selmans Network" por mungon referenca e realizimeve të shërbimeve dhe për ekspertin shqyrtues kjo dëshmi/e-mail nuk përmbush kërkesen e dosjes së tenderit.
Dy referencat tjera të lëshuara nga Univeristeti i Gjakovës në vlerë prej 133,232.08 € dhe Univeristeti i Pejës në vlerë prej 92,241.08 €,njëra pa datë të lëshimit dhe tjetra me datë të lëshimit 30.03.2020 nuk arrijnë të përmbushin vlerën e kërkuar prej 2,500,000.00 € për kontrata të realizuara në tri vitet e fundit.
Paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes së tenderit ka qene shumë e qartë që OE duhet të ofroj dëshmi të knaqshme se OE ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshem në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave,kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave dhe pretendimi i OE ankues se nuk ka mundur ti siguroj dëshmite e nevojshme për shkak të emergjencës shëndetsore (pandemia covid 19) për ekspertin shqyrtues është i pa qëndrueshëm sepse këto dëshmi(kontrata,referenca) OE është dashur ti kompletoj në rastin e dorëzimit të ofertës në e-prokurim,andaj duke pasur parasysh sqarimet e dhëna si më lartë,paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pa

bazuar"

Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të OE "Selmans Network"Shpk ndaj OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se te gjitha këto pretendime janë trajtuar në vendimet e OSHP-së, PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020 dhe disa nga këta OE janë palë pa interes juridik dhe material.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "EFA DIENSTLESTUNG"GMBH.**

Përgjigjie në pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE **"Efa Dienstleistung**"Gmbh se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve përsëri e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se lista e kontratave me referenca në tri vitet e fundit nuk është sipas kritereve të kërkuara,që sipas OE ankues ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.368-374-384/20,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretentim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj një pjesë të vendimit,"Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE "Efa Dienstleistung" Gmbh në ofertën e dorëzuar ka prezentuar një listë të kontratave dhe disa referenca për realizimin e shërbimeve në lëmin e pastrimit.Referenca nga Zyra e Infrastrukurës/Landi i Shtugartit e cila është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe e cila për vitet 2016,2017 dhe 2018 është mbi 4 milion euro dhe plotson kërkesën e dosjes së tenderit.
Nga AK nuk është sqaruar në asnjërin nga vendimet e tyre arsyeja se përse këto referenca nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit,andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar".
AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj informacione shtesë nga OE ankues lidhur me dokumentet e prezentuara lidhur me kontratat dhe referencat e realizuara.

Pretendimi ankimor është i bazuar

**Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë rivlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe rekomandimeve të vendimeve të OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020, por ka përsëritur vlerësimin paraprak duke anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së,andaj eksperti shqyrtues rekomandon që aktiviteti të kthehet në ri-vlerësim.**
**Gjatë procesit të rivlerësimit AK duhet të fokusohet më shumë në analizat financiare të OE se a janë konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe posaçërisht a i mbulojnë ofertat financiare kërkesat e ligjit të punës siç është kërkuar në dosje të tenderit.**

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të **aprovohen pjesërisht si të bazuara**,të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "UP HASAN PRISHTINA"
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "SCHAFBERGER JR" GMBH
- OE ankues - "SELMANS NETËORK"SHPK
- OE ankues - "EFA DIENSTLESTUNG"GMBH
- OE ankues - NSH"CLEAN";"REXHA SHPK